

SKK 12 EFEKTI I NDRYSHIMEVE TË KURSEVE TË KËMBIMIT

Pg.	
	STANDARDI KOMBËTAR I KONTABILITETIT NR. 12 – EFEKTI I NDRYSHIMEVE TË KURSEVE TË KËMBIMIT – I PËRMIRËSUAR
	PËRMBAJTJA <i>Paragrafët</i>
	OBJEKTIVI DHE BAZAT E PËRGATITJES 1-3
	FUSHA E ZBATIMIT 4
	PËRKUFIZIMET KRYESORE 5
	MONEDHA FUNKSIONALE 6-9
	RAPORTIMI NË MONEDHË FUNKSIONALE I TRANSAKSIONEVE NË MONEDHË TË HUAJ 10-28
	Njohja 10-12
	Raportimi në fund të periudhave raportuese të mëpasshme 13-14
	Njohja e diferencave nga kurset e këmbimit 15-18
	Investimet neto në një njësi ekonomike të huaj 19-20
	Konsolidimi i njësisve ekonomike të huaja 21-25
	Ndryshimi i monedhës funksionale 26-28
	PËRDORIMI I MONEDHËS RAPORTUESE TË NDRYSHME NGA MONEDHA FUNKSIONALE 29-32
	Përkthimi në monedhën raportuese 29-32
	SHËNIMET SHPJEGUESE 33-36
	DATA E HYRJES NË ZBATIM 37
	KRAHASIMI ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR PËR NJËSITË EKONOMIKE TË VOGLA DHE TË MESME (SNRF PËR NVM) 38
	BAZA E KONKLUZIONEVE
	UDHËZIM PËR ZBATIMIN E SKK 12
	OBJEKTIVI DHE BAZAT E PËRGATITJES
1	Objekti i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 12, <i>Efekti i kurseve të këmbimit</i> (‘SKK 12’ ose ‘Standardi’), i nxjerrë dhe i miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe shpallur nga Ministria e Financës, është dhënia e parimeve të njohjes, matjes e vlerësimit të mëpasshëm të transaksioneve në monedhë të huaj si dhe të shpjegimeve të nevojshme në pasqyrat financiare, të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Këto standarde bazohen në parimet e kontabilitetit dhe raportimit, të pranuar në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të të cilave përshkruhen në Ligjin nr. 9228, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, publikuar në prill 2004, i ndryshuar.
2	SKK 12 mbështetet në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit SNK 21, <i>“Efektet e ndryshimit në kurseve të këmbimit”</i> . SKK 12 është ndryshuar për t’u bërë i krahasueshëm me Seksionin 30 <i>Përkthimi i Monedhës së Huaj</i> të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për Njësitë e vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM). Një tabelë korresponduese e paragrafëve të standardit me paragrafë të SNRF për NVM është dhënë në paragrafin 38. Për rastet që nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga SKK 12 ose ndonjë SKK tjetër, drejtuesit e njësisë ekonomike duhet që, me miratimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të aplikojnë politika të tilla që sigurojnë një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare dhe ndryshimeve të fluksit të mjeteve monetare të njësisë ekonomike, siç kërkohet në nenin 9 të Ligjit nr. 9228, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, publikuar në prill 2004, i ndryshuar.
3	Pasqyrat financiare do të përgatiten mbi bazën e konceptit të materialitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit nuk do të zbatohen për zërat jomaterialë. Parimi i materialitetit përkufizohet dhe sqarohet në paragrafët 40 deri 90 të SKK 1.
	FUSHA E ZBATIMIT
4	Ky standard do të zbatohet:

	<p>(a) për trajtimin kontabël të transaksioneve dhe tepricave në monedhë të huaj;</p> <p>(b) për përkthimin e rezultateve dhe pozicionit financiar të veprimtarive në monedhë të huaj të kryera jashtë vendit, që përfshihen në pasqyrat financiare të njësive, nëpërmjet konsolidimit të plotë ose modelit të kapitalit;</p> <p>(c) për përkthimin e pasqyrave financiare në monedhën raportuese.</p> <p>Kontabilizimi i instrumenteve financiarë në monedhë të huaj trajtohen në përputhje me SKK 3 <i>Instrumentet Financiarë</i>.</p>
	PËRKUFIZIMET KRYESORE
5	<p>Më poshtë jepen përkufizimet e disa termave kryesore që përdoren në këtë standard:</p> <p><u>Kursi i këmbimit i mbylljes</u> është kursi i këmbimit në datën e raportimit.</p> <p><u>Diferenca nga kurset e këmbimit</u> është diferenca që vjen nga përkthimi i një shume të dhënë nga një monedhë në një monedhë tjetër (në lekë) me kurse të ndryshme këmbimi.</p> <p><u>Kursi i këmbimit</u> është kursi, me të cilin këmben dy monedha të ndryshme.</p> <p><u>Monedha e huaj</u> është çdo monedhë tjetër, përveç lekut.</p> <p><u>Njësi ekonomike e huaj</u> është një njësi në formën e një shoqërie të kontrolluar, pjesëmarrjeje, sipërmarrjeje të përbashkët ose dege të njësisë ekonomike, veprimtaritë e së cilës janë të bazuara ose kryhen në një vend të huaj dhe në një monedhë të ndryshme nga ajo raportuese e njësisë ekonomike.</p> <p><u>Grupi</u> përbëhet nga një shoqëri mëmë si dhe të gjitha njësitë e kontrolluara prej saj.</p> <p><u>Zëra monetarë</u> janë mjetet monetare të njësisë ekonomike, si dhe aktivet e detyrimet për t'u arkëtuar ose për t'u paguar me një numër të përcaktuar mjetesh monetare.</p> <p><u>Investimi neto në një njësi ekonomike të huaj</u> është shuma e interesit të njësisë ekonomike në aktivet neto të njësisë ekonomike të huaj.</p> <p><u>Kursi i këmbimit i menjëhershëm (spot)</u> është kursi i këmbimit për një lëvrim të menjëhershëm.</p>
	MONEDHA FUNKSIONALE
6	Çdo njësi ekonomike duhet të identifikojë monedhën e saj funksionale. Monedha funksionale e një njësie ekonomike është monedha e mjedisit primar ekonomik në të cilin operon njësia ekonomike.
7	<p>Zakonisht, mjedisi primar ekonomik në të cilin operon njësia ekonomike është ai në të cilin ajo kryesisht gjeneron dhe shpenzon mjete monetare. Prandaj, në përcaktimin e monedhës së saj funksionale, një njësi ekonomike ka parasysh faktorët e mëposhtëm:</p> <p>(a) monedhën: që kryesisht ndikon në çmimet e shitjes për mallrat, produktet dhe shërbimet (kjo shpesh do të jetë monedha në të cilën përcaktohen dhe paguhen çmimet e shitjes për mallrat, produktet dhe shërbimet e saj) si dhe, monedhën e vendit, forcat konkurruese dhe rregullimet e të cilit kryesisht përcaktojnë çmimet e shitjes së mallrave, produkteve dhe shërbimeve të saj.</p> <p>(b) monedhën që kryesisht ndikon në koston e punës, materialeve dhe kosto të tjera të ofrimit të mallrave dhe shërbimeve (kjo shpesh do të jetë monedha në të cilën përcaktohen dhe shlyhen kosto të tilla).</p>
8	<p>Faktorët vijues mundet gjithashtu të sigurojnë evidencë për monedhën funksionale të një njësie ekonomike:</p> <p>(a) monedha në të cilën gjenerohen fondet nga aktivitetet financuese (emetimi i instrumentave të borxhit dhe kapitalit)</p> <p>(b) monedha në të cilën merren zakonisht arkëtimet nga aktivitetet operative.</p>
9	<p>Faktorët vijues shtesë merren në konsideratë në përcaktimin e monedhës funksionale të një njësie ekonomike të huaj, dhe në përcaktimin nëse monedha e saj funksionale është e njëjtë me atë të njësisë ekonomike (njësia ekonomike, në këtë rast, është njësia ekonomike që ka njësinë ekonomike të huaj si filial të saj, degë, pjesëmarrje apo sipërmarrje e përbashkët):</p> <p>(a) nëse aktivitetet e njësisë ekonomike të huaj janë më tepër një zgjatim i njësisë ekonomike, sesa aktivitete me një shkallë domethënëse autonomie. Një shembull i situatës së parë është kur njësia ekonomike e huaj vetëm shet mallra të importuara nga njësia ekonomike dhe i paguan asaj shumat e arkëtuara. Një shembull i situatës së dytë është kur njësia ekonomike e huaj akumulon mjete monetare dhe zëra të tjerë monetarë, kryen shpenzime, gjeneron të ardhura dhe siguron huamarrje, të gjitha kryesisht në monedhën e saj vendase.</p> <p>(b) nëse transaksionet me njësinë ekonomike zënë një pjesë të madhe ose të vogël të aktiviteteve të njësisë ekonomike të huaj.</p> <p>(c) nëse flukset e mjeteve monetare nga aktivitetet e njësisë ekonomike të huaj prekin direkt flukset e mjeteve monetare të njësisë ekonomike dhe janë menjëherë të disponueshme për t'ju paguar asaj.</p> <p>(d) nëse flukset e mjeteve monetare nga aktivitetet e njësisë ekonomike të huaj janë të mjaftueshme për të paguar detyrimet ekzistuese apo ato të pritshme, pa financime nga njësia ekonomike.</p>
	RAPORTIMI NË MONEDHË FUNKSIONALE I TRANSAKSIONEVE NË MONEDHË TË HUAJ
	Njohja
10	Një transaksion në monedhë të huaj është ai transaksion, i cili është shprehur në monedhë të huaj ose shlyhet në monedhë të

	<p>huaj, përfshirë edhe ato transaksione që rrjedhin kur njësia ekonomike:</p> <p>(a) blen ose shet mallra, ose shërbime, çmimi i të cilave është i shprehur në monedhë të huaj; (b) merr ose jep hua, ku shumat për t'u paguar dhe për t'u arkëtuar janë të shprehura në monedhë të huaj; (c) përfiton ose heq dorë nga zotërimi i aktiveve dhe/ose merr përsipër apo shlyen detyrime të shprehura në monedhë të huaj.</p>
11	Një transaksion në monedhë të huaj në njohje, regjistrohet në monedhën funksionale, duke zbatuar mbi shumën e monedhës së huaj kursin e menjëhershëm të këmbimit (spot) ndërmjet monedhës funksionale dhe monedhës së huaj në datën e trasaksionit.
12	Data e transaksionit është data kur transaksioni fillimisht plotëson kushtet për njohjen në përputhje me SKK-të. Për arsye praktike, shpesh përdoret një kurs këmbimi, i cili është i përafërt me kursin e datës së kryerjes së transaksionit, p.sh. një kurs mesatar i një jave ose një muaji mund të përdoret për të gjitha transaksionet e kryera gjatë kësaj periudhe, në secilën prej monedhave të përdorura. Por, nëse gjatë periudhës ka luhatje të konsiderueshme të kursit të këmbimit, përdorimi i kursit mesatar është i papërshtatshëm.
	Raportimi në fund të periudhave raportuese të mëpasshme
13	Në fund të çdo periudhe raportuese, një njësi ekonomike duhet: <p>(a) të përkthejë zërat monetarë të shprehur në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit të mbylljes (d.m.th. në datën raportuese); (b) të përkthejë zërat jomonetarë që maten me kosto historike në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit; (c) të përkthejë zërat jomonetarë që maten me vlerën e drejtë në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë.</p>
14	Nëse kursi i këmbimit mes dy monedhave është përkohësisht i padisponueshëm, atëherë do të përdoret kursi i parë pasardhës, me të cilin mund të kryhet këmbimi.
	Njohja e diferencave nga kurset e këmbimit
15	Diferencat e këmbimit, që krijohen gjatë shlyerjes së zërave monetarë ose gjatë përkthimit të zërave monetare me kurse këmbimi të ndryshme nga kurset e këmbimit, me të cilat ato janë përkthyer në njohjen gjatë periudhës kontabël aktuale, ose në pasqyrat financiare të mëparshme, njihen si fitim (ose humbje) të periudhës kontabël kur ato lindin.
16	Kur një zë monetar rrjedh nga një transaksion në monedhë të huaj, dhe ka një ndryshim në kursin e këmbimit mes datës së kryerjes së transaksionit dhe datës së shlyerjes së tij, atëherë krijohet një diferencë këmbimi. Kur transaksioni shlyhet në të njëjtën periudhë kontabël, në të cilën ai është kryer, e gjithë diferenca e këmbimit njihet në të njëjtën periudhë kontabël. Megjithatë, kur një transaksion shlyhet në një periudhë kontabël të mëpasshme, diferenca e këmbimit, e njohur në secilën periudhë deri në datën e shlyerjes, përcaktohet nga ndryshimi i kurseve të këmbimit gjatë secilës nga periudhat kontabël.
17	Kur një përfitim ose humbje për një zë jomonetar njihet drejtpërdrejt në kapital, atëherë drejtpërdrejt në kapital do të njihet edhe diferenca e këmbimit. Por, kur përfitimi ose humbja nga një zë jomonetar njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, atëherë diferenca e këmbimit do të njihet, edhe ajo në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
18	Disa nga SKK-të e tjera kërkojnë që disa përfitime dhe humbje të njihen direkt në kapital. Për shembull, sipas SKK 5, disa përfitime ose humbje që vijnë nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale duhet të njihen drejtpërdrejt në kapital. Kur një aktiv i tillë është në monedhë të huaj, sipas paragrafit 13 (c) të këtij standardi, shuma përkatëse e rivlerësuar duhet të përkthehet duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur përcaktohet vlera, gjë që sjell një diferencë këmbimi, e cila gjithashtu duhet të njihet në kapital.
	Investimet neto në një njësi ekonomike të huaj
19	Një njësi ekonomike mund të ketë një zë monetar që është i arkëtueshëm ose i pagueshëm nga/ndaj një njësie ekonomike të huaj. Një zë për të cilin shlyerja nuk është planifikuar ose nuk është e mundshme të ndodhë në të ardhmen e parashikuar, është, në thelb, pjesë e investimeve neto të njësisë ekonomike në njësinë ekonomike të huaj dhe kontabilizohet në përputhje me paragrafin 20. Zëra të tillë monetarë mund të përfshijnë kërkesa të arkëtueshme afatgjata ose hua afatgjata. Ato nuk përfshijnë kërkesa të arkëtueshme ose kërkesa të pagueshme.
20	Diferencat e këmbimit që lindin nga një zë monetar që përbën pjesë të investimit neto të njësisë ekonomike në një njësi ekonomike të huaj, duhet të njihen në fitim ose humbje në pasqyrat e veçanta financiare të njësisë ekonomike raportuese ose në pasqyrat financiare individuale të njësisë ekonomike të huaj, si të jetë më e përshtatshme. Në pasqyrat financiare që përfshijnë të dyja, njësinë ekonomike të huaj dhe njësinë ekonomike (psh pasqyrat financiare të konsoliduara kur njësia ekonomike e huaj është filial), diferenca të tilla këmbimi duhet të raportohen si pjesë e kapitalit. Ato nuk duhet të njihen prapë në fitim ose humbje me shitjen ose heqjen dorë nga investimi neto.
	Konsolidimi i njësisë ekonomike të huaja
21	Për konsolidimin e aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve të një njësie ekonomike të huaj me ato të njësisë ekonomike, njësia ekonomike duhet të ndjekë procedurat normale të konsolidimit, si eliminimi i tepricave dhe transaksioneve të një filiali brenda grupit (shiko SKK 9 <i>Kombinimet e bizneseve dhe konsolidimi</i>).
22	Për konsolidimin e njësisë të kontrolluara të huaja dhe njësisë të tjera, pasqyrat financiare të njësisë që konsolidohet do të përkthehen nga monedha e huaj në monedhën raportuese.
23	Për të përkthyer pasqyrat financiare të njësisë së kontrolluar të huaj, të përgatitura në monedhë të huaj, do të përdoren kurset e këmbimit si më poshtë:

	<p>(a) të gjithë zërat e aktiveve dhe detyrimeve do të përkthehen me kursin e këmbimit të mbylljes (d.m.th. në datën e raportimit);</p> <p>(b) të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe ndryshimet e tjera të kapitalit, do të përkthehen me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit (për qëllime praktike, lejohet të përdoret kursi mesatar i ponderuar i këmbimit i periudhës kontabël).</p>
24	Meqenëse për përkthimin e pasqyrave financiare të njësisë së kontrolluar të huaj, të përgatitura në monedhë të huaj përdoren kurse të ndryshme këmbimi, diferencat që lindin nga përkthimi me kurse të ndryshme do të njihen në zërin e kapitalit “Diferenca të përealizuara të këmbimit”. Nëse shoqëria mëmë kontrollon më pak se 100% të njësisë së kontrolluar të huaj, atëherë pjesa që i përket aksionarëve të pakicës duhet të paraqitet veçmas.
25	Emri i mirë, që krijohet nga blerja e një njësie ekonomike të huaj, si dhe rregullimet me vlerën e drejtë të aktiveve dhe detyrimeve të blera, do të trajtohen si aktive dhe detyrime të njësisë ekonomike të huaj dhe do të përkthehen me kursin e mbylljes në përputhje me paragrafin 30.
	Ndryshimi në monedhën funksionale
26	Kur ka një ndryshim në monedhën funksionale të një njësie ekonomike, njësia ekonomike duhet të zbatojë përkthimin me monedhën e re funksionale në mënyrë prospektive që nga data e ndryshimit.
27	Siç është përkthuar në paragrafët 6 deri 9, monedha funksionale e një njësie ekonomike reflekton transaksionet, ngjarjet dhe kushtet bazë që janë të rëndësishme për njësinë ekonomike. Si rrjedhim, sapo përcaktohet monedha funksionale, ajo mund të ndryshohet vetëm nëse ka ndonjë ndryshim në këto transaksione, ngjarje dhe kushte të rëndësishme. Për shembull, një ndryshim në monedhën që kryesisht ndikon çmimet e shitjes së mallrave dhe shërbimeve, mund të çojë në një ndryshim në monedhën funksionale të njësisë ekonomike.
28	Efekti i ndryshimit në monedhën funksionale kontabilizohet në mënyrë prospektive. Me fjalë të tjera, një njësi ekonomike i përkthen të gjitha zërat në monedhën e re funksionale duke përdorur kursin e këmbimit në datën e ndryshimit të monedhës funksionale. Shumat që rezultojnë nga përkthimi për zërat jomonetarë trajtohen si kosto historike e tyre.
	PËRDORIMI I MONEDHËS RAPORTUESE TË NDRYSHME NGA MONEDHA FUNKSIONALE
	Përkthimi në monedhën raportuese
29	Nëse monedha raportuese ndryshon nga monedha funksionale, njësia ekonomike duhet t’i përkthejë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të pozicionit financiar nga monedha funksionale në monedhën raportuese. Për shembull, kur një grup përmban njësi ekonomike individuale me monedha të ndryshme funksionale, zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të pozicionit financiar të çdo njësie ekonomike shprehen në një monedhë raportuese të përbashkët në pasqyrat financiare të konsoliduara.
30	Një njësi ekonomike, duhet të përkthejë rezultatet e saj dhe pozicionin financiar në monedhën raportuese duke përdorur procedurat e mëposhtme: <p>(a) Aktivitetet dhe detyrimet për çdo pasqyrë të paraqitur të pozicionit financiar (përfshirë edhe të dhënat krahasimore) duhet të përkthehen me kursin e mbylljes në datën e raportimit.</p> <p>(b) Të ardhurat dhe shpenzimet për çdo pasqyrë të të ardhurave dhe shpenzimeve (përfshirë edhe të dhënat krahasimore) duhet të përkthehen me kurset e këmbimit në datat e transaksioneve.</p> <p>(c) Të gjitha diferencat që rezultojnë nga përkthimi duhet të njihen si zë i kapitalit.</p>
31	Për arsye praktike, për të përkthyer zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve, një njësi ekonomike mund të përdorë një kurs që i përfaqëson kurset e këmbimit në datat e transaksioneve, për shembull një kurs mesatar për periudhën. Gjithsesi, nëse kurset e këmbimit luhaten në mënyrë domethënëse, përdorimi i një kursi mesatar për periudhën është i papërshtatshëm.
32	Diferencat e këmbimit që i referohen paragrafi 30 (c) rezultojnë nga: <p>(a) përkthimi i të ardhurave dhe shpenzimeve me kurset e këmbimit në datat e transaksioneve, dhe i aktiveve dhe detyrimeve me kursin e këmbimit në datën e raportimit, dhe,</p> <p>(b) përkthimi i çeljes së aktiveve neto me kursin në datën e raportimit që ndryshon nga kursi paraardhës i raportimit.</p> <p>Kur diferencat e këmbimit lidhen me një njësi ekonomike të huaj që është konsoliduar, por nuk është 100% e zotëruar, diferencat e akumuluar të këmbimit që lindin nga përkthimi dhe i takojnë interesit jokontrollues në njësinë ekonomike të huaj, njihen si pjesë e interesit jokontrollues në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar.</p>
	SHËNIMET SHPJEGUESE
33	Njësi ekonomike duhet të paraqesë në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare informacionin e mëposhtëm: <p>(a) shumën e diferencave të këmbimit të njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, përveç atyre që rrjedhin nga matja e instrumenteve financiare, të matura me vlerën e drejtë, dhe që ndryshimet njihen në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve, në përputhje me SKK 3;</p> <p>(b) diferencën neto të këmbimit të klasifikuar si një zë më vete në kapital, si dhe një rakordim të kësaj diference në fillim dhe në mbyllje të periudhës kontabël.</p>
34	Në paragrafët vijues 35 dhe 36 referencat ndaj “monedhës funksionale”, në rastin e një grupi, kanë të bëjnë me monedhën funksionale të shoqërisë mëmë.
35	Një njësi ekonomike duhet të deklarojë monedhën në të cilën paraqiten pasqyrat financiare. Kur monedha raportuese është e ndryshme nga monedha funksionale, një njësi ekonomike duhet ta deklarojë këtë fakt dhe duhet të japë informacion shpjegues

	për monedhën funksionale dhe arsyen e përdorimit të një monedhe raportuese të ndryshme.	
36	Kur ka një ndryshim në monedhën funksionale të njësisë ekonomike raportuese ose të një njësie ekonomike të huaj të rëndësishme, njësia ekonomike duhet të deklarojë këtë fakt si dhe arsyen e ndryshimit të monedhës funksionale.	
	DATA E HYRJES NË ZBATIM	
37	Ky standard do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudhat kontabël, që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2015. Ky standard duhet të zbatohet në mënyrë prospektive.	
	KRAHASIMI ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR PËR NJËSITË EKONOMIKE TË VOGLA DHE TË MESME (SNRF PER NVM)	
38	Tabela më poshtë tregon se si korrespondojnë paragrafët e këtij standardi me SNRF për NVM . Paragrafët janë trajtuar si korresponduese, nëse ato trajtojnë në përgjithësi të njëjtën çështje, pavarësisht nga fakti se standardet e referuara mund të kenë ndryshim.	
	Paragrafët e SKK 12	Paragrafët e SNRF për NVM botuar në korrik 2009
	Paragrafi 1	Asnjë
	Paragrafi 2	Asnjë
	Paragrafi 3	Asnjë
	Paragrafi 4	Sek 30.1
	Paragrafi 5	Asnjë
	Paragrafi 6	Sek 30.2
	Paragrafi 7	Sek 30.3
	Paragrafi 8	Sek 30.4
	Paragrafi 9	Sek 30.5
	Paragrafi 10	Sek 30.6
	Paragrafi 11	Sek 30.7
	Paragrafi 12	Sek 30.8
	Paragrafi 13	Sek 30.9
	Paragrafi 14	Asnjë
	Paragrafi 15	Sek 30.10
	Paragrafi 16	Asnjë
	Paragrafi 17	Asnjë
	Paragrafi 18	Asnjë
	Paragrafi 19	Sek 30.12
	Paragrafi 20	Sek 30.13
	Paragrafi 21	Sek 30.22
	Paragrafi 22	Asnjë
	Paragrafi 23	Asnjë
	Paragrafi 24	Asnjë
	Paragrafi 25	Sek 30.23
	Paragrafi 26	Sek 30.14
	Paragrafi 27	Sek 30.15
	Paragrafi 28	Sek 30.16
	Paragrafi 29	Sek 30.17
	Paragrafi 30	Sek 30.18
	Paragrafi 31	Sek 30.19
	Paragrafi 32	Sek 30.20
	Paragrafi 33	Sek 30.25
	Paragrafi 34	Sek 30.24
	Paragrafi 35	Sek 30.26
	Paragrafi 36	Sek 30.27
	Paragrafi 37	Asnjë
	Paragrafi 38	Asnjë